

VENDIM
Nr. 736, datë 12.12.2018

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TE MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, TË DISA PASURIVE TË PALUAJTSHME, NË ZONËN KADASTRALE 8525, PËR UNIVERSITETIN E ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të disa pasurive të paluajtshme, në zonën kadastrale 8525, për Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si më poshtë vijon:

a) Pasuria e paluajtshme “truall”, me numër 7/215, në zonën kadastrale 8525, me sipërfaqe jashtë ndërtese 2 576.1 (dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë një) m², me emërtimin “mjedise të ish-Repartit Infektiv të Spitalit të Elbasanit”, sipas hartës treguese të regjistrimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi (lidhja 1);

b) Pasuria e paluajtshme “truall”, me numër pasurie 23/57/1, në zonën kadastrale 8525, me sipërfaqe jashtë ndërtese 3 196.3 (tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tre) m², me emërtimin “mjedise të ish-Maternitetit Elbasan”, sipas hartës treguese të regjistrimit bashkëlidhur këtij vendimi (lidhja 2);

c) Pasuria e paluajtshme “ndërtesë” 1 (një) kat (lavanteri), me numër pasurie 23/57/1, në zonën kadastrale 8525, me sipërfaqe 106 (njëqind e gjashtë) m², sipas hartës treguese të regjistrimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi (lidhjet 2 dhe 2/1);

ç) Pasuria e paluajtshme “ndërtesë” 1 (një) kat (garazh), me numër pasurie 23/57/1, në zonën kadastrale 8525, me sipërfaqe 35.7 (tridhjetë e pesë pikë shtatë) m², sipas hartës treguese të regjistrimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi (lidhjet 2 dhe 2/2).

2. Pasuritë e paluajtshme, pas kalimit në përgjegjësi administrimi, të përdoren në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

3. Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojë apo t’ua japë ato në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

ELBASAN

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8525 NR.PASURISE 7/215 VOL. ____ FQ. ____
INDEKSI I HARTES EL ; I-8 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE: RRETHI ELBASAN Q/F ELBASAN
Rr/L " HAXHIAS " P/G ____ SH ____ K ____ Ap

B. KUFIZIMET

V. 7/38,7/27
L. 7/27,7/39
J. 7/19,7/14
P. 7/89


C. PRONARI

SHTET

D.DATA 29/08/2018 ORA.10.00



Vula.





HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
ELBASAN**

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8525 NR.PASURISE 23/57/1 VOL. ____ FQ. ____
INDEKSI I HARTES EL ; K - 9, L - 9 SHKALLA 1:1000
ADRESA E PASURISE: RRETHI ELBASAN Q/F ELBASAN
Rr/L " 5 MAJ " P/G ____ SH ____ K ____ Ap

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

SHTET

V. 23/38,23/41,23/42,23/42
L. 23/42,23/51,23/52,23/55,23/56
J. 23/175,23/133
P. 23/63,23/62,23/61,23/58,23/59,23/60

D.DATA 29/08/2018 ORA.10.00




Vula.



PLANIMETRIA E GODINES GARAZH (ISH - MATERNITETI)

SH 1 : 50



MIRATOI
ADMINISTRATOR
Eljan HOXHA

SHPJEGUES

- Sipërfaqe ndertimi 35.7 m²
- Sipërfaqe e përgjithshme 35.7 m²

ELBASAN Lic. K.0791	OBJEKTI : GARAZH (Ish-Matemiteti)Q. Spilakore "Xh.Konjoli"- Elbasan PLANIMETRIA E GARAZHDIT (Ish - Matemiteti)
	Projektues Ing.D.Konica
	Punoi Ing.D.Konica
SH : 1 -100	Topografia Ing.Top. E.Pepa